

Procedurat dhe mekanizmat për të bërë ankesë ose kërkesë që lidhen me veprimet ose mosveprimet e AP. (Përfshirë adresën postare elektronike për depozitimin e kërkesave)

Subjektet mund të paraqesin kërkesë ose ankesë që lidhet me veprimet ose mosveprimet e Institucionit nëpërmjet depozitimit të saj në zyrën e protokollit, nëpërmjet postës në adresën, Lagjja: “Hajro Çakërr”, Rr. “Sulejman Delvina”, Vlorë ose në adresën elektronike prefekti.vlore@mb.gov.al. Ankimi shqyrtohet brenda afateve të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë 30 ditë nga paraqitja e ankimit, përveçse kur parashikohet ndryshe në ligjin e posaçëm.

Aktet administrative të Institucionit të Prefektit të Qarkut mund të ankimohen drejtpërdrejtë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligjin e posaçëm, si p.sh në ligjin për të drejtën e informimit, në ligjin për prokurimin publik, Kodin Rrugor të Republikës së Shqipërisë etj.